



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË

Nr. 5241 prot.,

Tiranë 24/10/2024

**NJOFTIM**

**PËR SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil”, vendimin nr.643, datë 23.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullave standarte për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”, udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurimit të hapur” si dhe vendimit nr 17, datë 10.10.2024 të Këshillit të Gjykatës, “Për shpalljen e disa vendeve vakante në organikën e Gjykatës së Lartë”, Gjykata e Lartë, shpall procedurën e “Lëvizjes paralele” dhe “Pranim në shërbimin civil gjyqësor” për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

- **1(një) vend vakant , pozicioni specialist në Sektorin e Sigurisë , Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë , kategoria ekzekutive, IV-1.**

*Pozicionet më sipër u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se nga këto pozicione , në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele , rezulton se ende ka pozicione vakante ,ato janë të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive.*

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

**LËVIZJE PARALELE:**

**07 nëntor 2024**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

**PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR**

**14 nëntor 2024**

Specialisti në Sektorin e Sigurisë kryen detyra dhe veprime procedurale/administrative/juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Misioni i tij/saj kryesor është mbajtja e rendit dhe sigurisë në Gjykatën e Lartë.

Specialisti në Sektorin e Sigurisë ushtron detyrat kryesore si më poshtë:

- a) Garanton ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe perimetrin e sigurisë rreth saj, në 5 (pesë) metra largësi;
- b) Dokumenton dhe regjistron në një regjistër të veçantë hyrje-daljet në ambientet dhe hapësirat e Gjykatës së Lartë (hyrjet e veçanta dhe kryesore), me emër, mbiemër, vizitë, datë, orë dhe zyrën ku është lejuar vizita;
- c) Mbikëqyr hyrjet e godinës (hyrjet e veçanta dhe kryesore) së Gjykatës, duke mos lejuar personat e paautorizuar, si dhe ato jashtë orarit zyrtar 08:00 - :16:00;
- ç) Kontrollon personat që hyjnë në ambientet e Gjykatës së Lartë në hyrjet kryesore e të veçanta;
- d) Kontrollon dhe mbikëqyr hyrjet e automjeteve në ambientet e Gjykatës së Lartë, portat hyrëse dhe hapësirat e parkimit në institucion;
- dh) Përdor pajisjet elektronike/detektorët elektronikë për të ndaluar hyrjet e paautorizuara në Gjykatën e Lartë;
- e) Përdor pajisjet e testuara për fikjen e zjarrit në ambientet e institucionit, si dhe sistemin e alarmit të zjarrit;
- f) Monitoron, kontrollon dhe mbikëqyr pajisjet dhe sistemin e kamerave të vëzhgimit të lidhura me detektorë alarmi, si dhe atë elektronik të lejimit të hyrjes në godinë;
- g) Garanton rendin, qetësinë dhe solemnitetin në sallën e gjyqit;
- gj) Kontrollon dhe ndalon futjen e artikujve dhe objekteve të ndaluara/paautorizuara në Gjykatën e Lartë;
- h) Regjistron dhe ruan përkohësisht sendet e personit që hyn në institucion, në vende të krijuara posaçërisht për këtë qëllim;
- i) Ndalon futjen e personave të ndaluar/paautorizuar në Gjykatën e Lartë;
- j) Ushtron kontroll personal nëpërmjet pajisjeve teknike dhe verifikon çantat e personave që hyjnë në ambientet e brendshme të institucionit;
- k) Informon titullarin e institucionit përkatës dhe në mungesë të tij, kancelarin, për sjellje të dyshimta, rrezik apo kërcënim nga personat që ndodhen brenda apo jashtë ambienteve të institucionit;
- l) Përdor forcën fizike në përputhje dhe proporcion me rastet që e kanë diktuar atë dhe aq sa është e nevojshme për të shmangur apo neutralizuar situatën e rrezikut të krijuar;
- ll) Garanton sigurinë e aktiveve, duke nisur nga mbyllja e dritareve, gjendjen e materialeve në zyrë, heqjen nga priza të mjeteve të ngrohjes, fikjen e dritave, mbylljen e derës, etj.
- m) Të kenë dëshirë dhe gatishmëri për të arritur nivele më të larta të profesionalizmit duke marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme dhe aktivitete që lidhen me aftësimin e mëtejshëm profesional;

n)Të tregojë dëshirë dhe iniciativë për zbatimin e metodave bashkëkohore të punës me qëllim rritjen e efektivitetit të njësisë ku bën pjesë dhe të ketë njohuri mjaft të mira në fushën e sigurisë dhe të paraqesë periodikisht plane masash për rritjen e sigurisë në institucion.

nj)Të ketë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi me kolegët e sektorit por edhe me njësitë e tjera të Gjykatës, me qëllim realizimin e detyrave që i ngarkohen.

## **I. LËVIZJA PARALELE.**

*Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor,(kategoria IV-1).*

### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori.
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë një diplomë “Master Shkencor “ose barasvlershëm me të (2 vite akademike) në studimet e larta universitare, në fushën e sigurisë dhe të rendit, shkencat juridike dhe në fusha të tjera të përshtatshme me përshkrimin e punës. Edhe diploma “Bachelor” duhet të jetë në një prej këtyre fushave.
- Të ketë të paktën 5 (pesë) vite pune në fushën e sigurisë dhe të rendit në institucionet publike të rëndësisë së veçantë pjesë e sistemit gjyqësor
- Të ketë njohuri në gjuhën angleze ose të një gjuhe tjetër të BE-së në nivel profesional.
- Të ketë aftësi shumë të mira organizative, komunikimi, si dhe për të punuar në grup.
- Të ketë njohuri praktike në përdorimin e programeve të kompjuterit.

### **I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës **07.11.2024**, pranë Gjykatës së Lartë ose në rrugë postare në adresën : *Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë* dokumentat e mëposhtëm:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.
- Jetëshkrim i përditësuar.
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave.

- Fotokopje të librezës së punës, (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Dokument të gjuhës së huaj.
- Vërtetim të gjendjes shëndetsore (raport i aftësisë në punë).
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (formulari i vetdeklarimit të gjendjes gjyqësore).
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Vërtetim banimi.
- Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;

Inkurajohen të paraqesin interesin e tyre edhe kandidatet gra, me qëllim garantimin e përfaqësimit sa më të drejtë gjinor në këtë sektor.

***Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.***

*Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.*

### **I.3. VLERËSIMI I DOKUMENTACIONIT**

Verifikimi paraprak, i përmbushjes së kushteve minimale për pozicionin e punës dhe kërkesave të veçanta në shpalljen për konkurrim, do të kryhet brenda datës **11.11.2024**, në ambientet e Gjykatës së Lartë, dhe do të shpallet lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim dhe listat e atyre që nuk i plotësojnë.

Këshilli, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin profesional të kandidatëve.

**Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind)**

Mënyrën e vlerësimit të kandidatëve sipas kësaj procedure do ta gjeni në udhëzimin nr.85 , datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur”

Intervistës me gojë nga Këshilli i Gjykatës së Lartë lidhet me njohuritë, aftësitë, kompetencat që nevojiten për pozicionin e punës, eksperiencën, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e karrierës.

### **I.4. DATA E DALJES SË REZULTATEVE DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të daljes së rezultateve të vlerësimit të kandidatëve, njoftimi me emrat e kandidatëve fitues do të shpallet në faqen zyrtare të KLGJ-së [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe në faqen web të gjykatës, [www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al)

Njoftimi dhe komunikimi për kandidatët do të jetë nëpërmjet adresës së e-mail të kandidatit.

## **II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

*Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive.*

Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës duke filluar nga data **11.11.2024** për pozicionin specialist i sigurisë, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë.

Ky informacion do të shpallet në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Marrëdhëniet me publikun -Vende vakante”.

### **II.1 KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA**

Kandidatët për pranimin në shërbimin civil gjyqësor për të dy vendet e shpallura duhet të plotësojnë:

**Kriteret e përgjithshme** që duhet të përmbushin kandidatët që konkurrojnë sipas kësaj procedure janë si më poshtë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil apo shërbimi civil gjyqësor, që nuk është shuar sipas ligjit.

**Kërkesat e veçanta** që duhet të plotësojnë kandidatët janë :

- Të jetë i diplomuar në drejtësi, në fushën e sigurisë dhe të rendit, *ose në fusha të tjera të përshatshme me përshkrimin e punës*), të paktën në nivelin "Master shkencor" ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;
- Të ketë kryer të paktën një vit praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër në fushën e rendit dhe sigurisë në gjykatë. Pasja e certifikatës së sigurisë është një avantazh që do të merret në konsideratë.
- Të ketë përvojë pune në fushën e sigurisë dhe ruajtjes në institucione apo eksortimit të personaliteteve të larta shtetërore .
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze në nivel profesional (gjuha juridike), preferohet njohja në nivel profesional e një gjuhe të dytë .

- Të ketë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi me kolegët.

## **II.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës **14.11.2024**, në ambjentet e Gjykatës së Lartë ose nëpërmjet postës, në adresën : *Gjykata e Lartë, Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë* dokumentat e mëposhtëm:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.
- Jetëshkrim i përditësuar
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave.
- Fotokopje të librezës së punës,
- Fotokopje të çertifikatave të trajnimeve apo kualifikimeve (nëse ka).
- Dokument që vërteton njohuritë e gjuhës së huaj.
- Vërtetim të gjendjes shëndetsore (raport i aftësisë në punë).
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore ,
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Vërtetim banimi.
- Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Vërtetim nga gjykata
- Vërtetim nga prokuroria

Inkurajohen të paraqesin interesin e tyre edhe kandidatet gra, me qëllim garantimin e përfaqësimit sa më të drejtë gjinor në këtë sektor.

### ***Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.***

*Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ( dy ) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.*

## **II.3 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

- Njohjes së legjislacionit në fushën e sigurisë dhe ruajtjes së rendit.
- Vendim nr. 622, datë 10.12.2020 ” Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”.

#### **II.4 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive do të marrin informacion në faqen e Gjykatës së Lartë dhe KLGJ-së për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- **Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraparak.**
- **Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi** (*provimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë* )

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Gjykatës së Lartë, [www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al) dhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor [www.klgj.al](http://www.klgj.al) duke filluar nga data **18.11.2024**. Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

*Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten tek Kancelari i Gjykatës, brenda 2 ( dy ) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ( dy ) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.*

#### **II.4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Vlerësimi i kandidateve do të bëhet si më poshtë:

1. 60 pikë për rezultatet e testit me shkrim;
2. 40 pikë nga Komisioni i Pranimit dhe Këshilli i Gjykatës:

Brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga përfundimi i testimit me shkrim, ftohen kandidatët për intervistë dhe kandidati për vendin e lirë përkatës zgjidhet, duke marrë parasysh kriteret sipas pikëzimit si vijon:

- a) renditjen në listën e kandidatëve, sipas pikëve të vlerësimit me shkrim;
- b) 25 pikë për karakteristikat e veçanta të kandidatit në bazë të intervistës së strukturuar me gojë,
- c) 15 pikë për vitet e përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvoja të tjera profesionale që lidhen me vendin përkatës.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a – Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;

b – Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c – Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **II.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Data e daljes së rezultateve do të bëhet duke filluar nga data **27.11.2024**. Pas arsyetimit dhe publikimit të vendimit për rezultatet e procedurës së emërimit nga Këshilli, ky vendim do t'u njoftohet të gjithë kandidatëve. Këshilli, pas marrjes së mendimit me shkrim nga kandidati fitues, shpall fituesin në faqen web të Gjykatës së Lartë [www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al) dhe faqen zyrtare të KLGJ-së, [www.klgj.al](http://www.klgj.al).

### **KËSHILLI I GJYKATËS GJYKATA E LARTË**

*Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë*